



Përmbledhja


## Gjendja e Popullsisë Botërore 2013

### Amësia në fëmijëri: Përballja me sfidën e shtatzënisë në adoleshencë

Çdo ditë, në vendet në zhvillim, 20.000 vajza nën moshën 18 vjeç të lindin. Nëntë në 10 prej këtyre lindjeve ndodhin brenda martesës apo bashkëjetesës.

Vajzat nën 15 vjeç llogariten të jenë 2 milion nga totali vjetor prej 7.3 milion nëna të reja adoleshente, dhe nëse vazhdojnë trendet aktuale, numri i lindjeve të vajzave nën 15 vjeç mund të rritet deri në 3 milion në vitin 2030.

*Gjendja e Popullsisë Botërore* UNFPA, Fondi për Bashkuara, nxjerr në pah shtatzënisë së ndikimet e saj serioze mbi mundësitë afatgjata për Raporti gjithashtu tregon për të frenuar këtë prirje drejtat dhe mirëqenien e



2013, botuar nga Popullsi i Kombeve të sfidat kryesore të adoleshentëve dhe shëndetin, arsimimin dhe punësim të vajzave. se çfarë mund të bëhet dhe për të mbrojtur të vajzave.

Në çdo rajon të botës, paarsimuara dhe ato të shumë gjasa të ngelen pasura, më të arsimuara urbanizuara.

vajzat e varfëra, të zonave rurale kanë më shtatzëna se sa vajzat e dhe të zonave të

Vajzat nga pakicat etnike apo grupet e marginalizuara, si dhe ato që kanë qasje të kufizuar ose s'kanë fare qasje në shëndetin seksual dhe reprodaktiv janë gjithashtu në rrezik më të madh.

Shtatzënia ka pasoja të mëdha në shëndetin e një vajze, thotë raporti, pasi problemet shëndetësore kanë më shumë gjasa të shfaqen tek vajza nëse ajo ngelet shtatzënë shumë shpejt pas arritjes së pubertetit. Rreth 70,000 adoleshentë në shtetet në zhvillim vdesin çdo vit nga shkaqe që lidhen me shtatzëninë dhe lindjen. Adoleshentët që ngelen me barrë priren të jenë nga familje me të ardhura të ulëta dhe me ushqyeshmëri më të dobët.

Raporti tregon se vajzat që qëndrojnë më gjatë në shkollë kanë më pak gjasa të ngelen me barrë. Arsimimi përgatit vajzat për punë dhe jetë në të ardhmen, ngre vetëvlerësimin dhe statusin e tyre, dhe u jep atyre më shumë “zë” në vendimet që ndikojnë në jetën e tyre. Arsimimi gjithashtu zvogëlon gjasat e martesës së fëmijëve dhe vonon lindjet e fëmijëve, përfundimisht çon në rezultate më të mira të lindjes.

Raporti aplikon një kornizë ekologjike shumë-niveleshe, e cila tregon se shtatzënitë në adoleshentë nuk ndodhin në një vakum. Ato janë pasojë e një kombinimi të faktorëve, duke përfshirë edhe varfërinë, pranimin e martesës së fëmijëve nga komunitetet dhe familjet, dhe përpjekjet e pamjaftueshme për të mbajtur vajzat në shkollë.

Për më tepër, shtatzëni të tilla, veçanërisht në mesin e vajzave nën 15 vjeç, nuk janë rezultat i një zgjedhjeje të paramenduar, por më tepër janë mungesë e zgjedhjes, dhe rrethanave që janë përtej kontrollit të vajzave. Shtatzënitë e hershme pasqyrojnë varfërinë, pafuqinë dhe presionet-nga partnerët, shokët, familjet dhe komunitetet. Dhe në shumë raste, ato janë rezultat i dhunës apo detyrimit seksual.

Vajzat nën 15 vjeç janë më të ndjeshme/cënueshme, dhe në këtë drejtim nuk është bërë aq sa duhet për t'i kuptuar dhe për t'iu përgjigjur sfidave të tyre të veçanta dhe të frikshme, thotë raporti. Përpjekjet për të parandaluar shtatzënitë në mesin e vajzave më të medha se 15 vjeç, ose për të mbështetur adoleshentet më të vjetër që janë shtatzënë ose kanë lindur, mund të mos jenë të përshtatshme ose relevante për adoleshentët e rinj. Ky grup veçanërisht i pambrojtur ka nevojë për qasje strategjike që adresojnë situatën e tyre unike.

Shtazënia tek adoleshentët është në të njëjtën kohë edhe shkak dhe pasojë e shkeljes së të drejtave. Shtazënia minon aftësinë e vajzës për të ushtruar të drejtat e saj në arsim, shëndetësi dhe autonomi. Në anën tjetër, kur një vajzë nuk ka mundësi të gëzojë të drejtat themelore, ajo ka më shumë gjasa të ngelet shtatzënë.

### **Amësia në fëmijëri: Përballja me sfidën e shtazënisë në adoleshencë**

Çdo ditë, për rreth 200 vajza adoleshente, shtazënia e hershme rezulton me shkeljen e të drejtave bazë: vdekje.

Sipas Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës, çdokush që është nën moshën 18 vjeçare konsiderohet fëmijë.

Fëmijëve i'u janë siguruar masa mbrojtëse të veçanta, varësisht nga mosha e tyre. Mbështetja e këtyre masave mbrojtëse mund të ndihmojë në eliminimin e shumë prej rrethanave që kontribuojnë në shtazëninë e adoleshentëve dhe zbutjen e pasojave për vajzën, familjen dhe komunitetin e saj. Kjo do të ndihmojë në përfundimin e një

cikli vicioz të shkeljes së të drejtave, varfërisë, pabarazisë, përjashtimit dhe shtatzënisë të adoleshentëve.

Raporti vë në dukje se disa qeveri dhe komunitete kanë qenë në gjendje të reduktojnë fertilitetin e adoleshentëve përmes veprimeve të dizajnuara për të arritur objektivat e tjera, të tilla si mbajtja e vajzave në shkollë, parandalimin e infeksionit HIV, duke i dhënë fund martesës së fëmijëve, fuqizimit të vajzave për të marrë vendime jetësore, dhe respektimit të të drejtave themelore të njeriut.

Shumë vende kanë ndërmarrë veprime që synojnë në veçanti parandalimin e shtatzënisë në adoleshentë, dhe në disa raste, mbështetjen e vajzave që kanë ngelur shtatzënë. Megjithatë, shumë nga këto masa kanë qenë kryesisht në lidhje me ndryshimin e sjelljes së vajzës, pa adresuar shkaqet, përfshirë pabarazisë gjinore, varfërinë, dhunën seksuale, martesën e fëmijëve, presionet sociale, si dhe qëndrimet negative dhe stereotipet rreth vajzave adoleshente. Strategjitë e kanë neglizhuar shpesh marrjen parasysh të rolit që djemtë dhe burrat mund të luajnë në adresimin dhe parandalimin e shtatzënisë në adoleshentë.

Raporti *Gjendja e Popullsisë Botërore 2013* bën thirrje për një ndryshim nga ndërhyrjet që shënjestrojnë vajzat drejt qasjeve me shtirje të gjerë që ndihmojnë vajzat të marrin vendime në lidhje me jetën e tyre, duke përfshirë edhe çështjet e shëndetit seksual dhe riprodhues, dhe u ofrojnë atyre mundësi reale që të mos shikojnë amësinë si fatin e vetëm të tyre. Kjo qasje e re duhet të synojë, në njërën anë, rrethanat, kushtet, normat, vlerat dhe forcat strukturore që mbizotërojnë në shtatzënitë e adoleshentëve dhe në anën tjetër ato që izolojnë dhe marginalizojë vajzat shtatzëna. Vajzat duhet të kenë qasje në shërbime, si në ato shëndetësore seksuale dhe riprodhuese poashtu edhe në informacion.

Ato kanë nevojë për t'u liruar nga presionet ekonomike dhe sociale që shumë shpesh kthehen në një shtatzëni, si dhe nga varfëria, shëndeti i dobët dhe potenciali i parealizuar njerëzor që vijnë me të.

Përballja me shtatzënaninë e padëshiruar në mesin e adoleshentëve kërkon qasje holistike. Meqë sfidat janë të mëdha dhe komplekse, asnjë sektor apo organizatë nuk mund të përballlet me to I vetëm. Vetëm duke punuar në partneritet, me të gjithë sektorët, dhe në bashkëpunim me vetë adoleshentët, mund të hiqen kufizimet që lidhen me përparimin e tyre.